



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4353/Prot.

Elbasan, më 17.08.2026

VENDIM

Nr. 675 datë 17.08.2026

“Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave”

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrativ të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në nenet 8, 9, 59 e 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe në nenet 28 e 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i R.Sh.” (i ndryshuar);

VENDOSA:

- 1) Zv/kryetari i Bashkisë, **z. ASIM SULA**, është përgjegjës për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave si dhe strukturave vartëse të saj.
- 2) Zv/kryetari i Bashkisë, **z. ASIM SULA**, është përgjegjës për drejtimin, monitorimin dhe koordinimin e aktivitetit të Agjencisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe strukturave vartëse të saj, të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane si dhe të Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale.
- 3) Në funksion të realizimit të përgjegjësi si mësipër, zv/kryetari z. Asim Sula, i delegohen kompetencat si mëposhtë:
 - *Kontrollon dhe nënshkruan të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësi të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, me përjashtim të instrumentave të planifikimit të territorit dhe lejeve të zhvillimit e ndërtimit, të cilat do të nënshkruhen nga Kryetari i Bashkisë;*
 - *Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshill Bashkiak, si relacione, projektvendime etj., që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësi të përcaktuara në këtë vendim si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të këtij këshilli;*

- 4) Aktet dhe shkresat zyrtare, të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njëloj të detyrueshme për Administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.
- 5) Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data 17.8.2026 deri në një urdhër të dytë.
- 6) Zv/kryetari, z. Asim Sula, nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera të Bashkisë.
- 7) Zv/kryetari, z. Asim Sula, do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.
- 8) Vendimi nr. 88 datë 28.01.2025 i Kryetarit të Bashkisë dhe të gjitha aktet e tjera të delegimit të kompetencave për zv/kryetarin, z. Asim Sula, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
- 9) Ngarkohen zv/kryetari, z. Asim Sula, dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, me publikimin e tij.
- 10) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

KRYETARI
Gledian Llatja

